



Datë 107.03.2016
Nr 234 prot.

BASHKIA E TIRANËS
KRYETARI

URDHËR,

Nr. 7244 datë 04.03 2016

Për

“Riorganizimin e strukturës organizative të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, Institucion në Varësi të Bashkisë së Tiranës”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 dhe nenit 64 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, “Kodi i Procedurave Administrative” (i ndryshuar), Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), nenit 5 të ligjit nr.10405, datë 24.03.2011 “Kompetencat për përcaktimin e pagave të punës” i ndryshuar, VKM-së nr. 1619 datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page, dhe për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore” (i ndryshuar), VKB nr. 56, datë 24.12.2012 Për “Riorganizimin e strukturës organizative të disa Institucioneve në varësi të Bashkisë së Tiranës”, VKB-së nr. 58 data 31.12.2015 për “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016”.

URDHËROJ:

1. Miratimin e ndryshimit të organikës të Qendrës Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, njësi në varësi të Bashkisë së Tiranës, sipas organigramës bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Numri i përgjithshëm i punonjësve të Qendrës Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve është gjithsej 626 vetë dhe detajohet sipas organikës bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Efektet financiare në paga dhe sigurime shoqërore do të përballohen nga Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve për vitin 2016.
4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Erion Veliaj

KRYETARI

Erion Veliaj